



Data: 18.05.2018

Ref.: 495/18D

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë: 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 53-të, të mbajtur më 22 Shtator 2017, mori:

V E N D I M

I. Refuzohet kërkesa nr.574/17 e datës 21.07.2017 e Akademia "Evolucion". Mbetet në fuqi vendimi i KSHC-së nr. 547/17 i datës 06.07.2017.

Arsyetimi

Akademia "Evolucion" ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim nr.680/18 e datës 20.09.2017 të vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) nr. 581/17 i datës 06.07.2017 në lidhje me mos ri/akreditimin e programit të studimit Arte Mediale BA.


Pas shqyrtimit të kërkesës KSHC mori vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të Akademia "Evolucion". KSHC konsideroi se gjendja faktike e Akademia "Evolucion" në kohën e vlerësimit është trajtuar me saktësi nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit dhe KSHC-së. KSHC me qëllim të konfirmimit të kësaj gjendje, më datë 01.09.2017 ka kontaktuar sërish me ekipin e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit dhe ka kërkuar nga ta që të konfirmojnë përmes një raporti/ shkresë të dytë gjetjet e tyre gjatë vlerësimit të programit të studimit Arte Mediale të Akademia Evolucion. Edhe në raportin/ shkresën e dytë të dërguar nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit, të njejtin kanë konfirmuar gjetjet e tyre dhe se kanë ritheksuar se të njejtin nuk e rekomandojnë për ri/akreditim programin e studimit BA Arte Mediale të Akademia Evolucion.

Duke pasur parasysh arsyet e cekura më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendim.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 131, të Ligjit mbi Procedurën Administrative Nr. 05/L-031. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Akademia Evolucion;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

